



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 393/7 prot.

Tiranë, më 12. 11. 2020

Lënda: Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Për dijeni: Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

Depozituar pranë: Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.10.2020, është njoftuar vendimi nr. 286, datë 4.8.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 11.11.2020, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, neni F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLJGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Genti Shala ”², ka referuar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit³ mbi Kontrollin e Figurës të z. Genti Shala ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Genti *** Shala. Pas kërkesës së Komisionit⁴ për përditësimin e raportit fillestar, DSIK ka përcjellë raportin e përditësuar për subjektin e rivlerësimit, duke gjykuar që: *për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ...*

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁵ e hartuar për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Komisioni e ka shtrirë hetimin në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë ***.2.2018.

Raport i KLGJ-së nr. *** prot., datë ***.11.2019.

³ Dërguar me shkresën nr.*** prot., datë ***.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. *** , datë ***.7.2019.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2020.

⁵ Shkresa e KLGJ-së, nr. *** prot., datë ***.11.2019.

ardhurave, shpenzimeve etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë [...] (f. 53 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Gent Shala, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

3.2 Për kontrollin e figurës. Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsytuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Genti Shala, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...] (f. 53 e vendimit).*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i njëjës prej dosjeve të gjykuara nga subjekti, arsytuar në pikën 4.6, është e pamjaftueshme⁶ për të arritur në vlerësimin e tij sipas shkronjës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 53 e vendimit).*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 286, datë 4.8.2020, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Genti Shala, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë”, dhe në pikën 2 të dispozitivit “2. Transferimin e çështjes gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë ***.7.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”.*

⁶ Nenin E, pika 1 të aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre, të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”; - Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”; - Vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036, të Komisionit të Venecias).

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “C”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65/2,6 të ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre Vëzhgues Ndërkombëtarë të ONM-së, më datë 11.11.2020, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: *“Rekomandim për paraqitje ankimi”* ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Genti Shala (bashkëlidhur këtij ankimi së bashku me denoncimin e datës 10.11.2020).

6. Komisioni i tre Vëzhguesve Ndërkombëtarë rekomandon ankimin kundër vendimit të Komisionit, me qëllim hetimin e mëtejshëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit të të dyja çështjeve.

6.1 Çështjet për të cilat kërkohet hetim i mëtejshëm në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit janë si vijon: (i) në datën 10.11.2020, pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, është paraqitur një denoncim, ku pretendohet për pronësinë e subjektit të rivlerësimit në një shoqëri ndërtimi, denoncim i cili, bazuar në këtë rekomandim, duhet shqyrtuar gjatë procedurës gjyqësore në Kolegj; (ii) një kontratë noteriale huaje, e vitit 2015, e evidentuar nga korrespondenca me Ministrinë e Drejtësisë, për të cilën Komisioni nuk ka hetuar.

6.2 Në rekomandimin përkatës vlerësohet se rezultatet e hetimit të mëtejshëm nga Kolegji mbi dy çështjet e mësipërme, marrë në konsideratë zbatimin e jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi: (a) analizën financiare për periudhën 2003 - 2016; (b) çështjet e rrjedhura nga transaksionet e pronësisë mbi një apartament me sipërfaqe 79 m,² i blerë nga kompania “****” sh.p.k. dhe (c) përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë ***.7.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë (e referuar kjo e fundit për inspektim nga Komisioni), mund të çojnë organin rivlerësues që të marrë në shqyrtim zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra bazuar në nenin 58 , pika 1, germa “c”, e ndërlidhur me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat

kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe në një vlerësim të drejtë të provave të administruara.

11. Në referencë të kësaj pozite procedurale në procesin e rivlerësimit, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi Rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në lidhje me elementet e reja, të pahetuara dhe të arsyetuara më parë, gjatë hetimit dhe vendimit të Komisionit, të cilat parashtrihen në përmbajtjen dhe janë pjesë e këtij rekomandimi, vlerëson se nevoja për një hetim të mëtejshëm në drejtim të këtyre elementeve, përkatësisht: **(i)** një denoncimi të ardhur në adresë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në datën 10.11.2020, në lidhje me pronësinë e subjektit të rivlerësimit në një shoqëri ndërtuese dhe **(ii)** një kontratë huaje të vitit 2015, pasqyruar në regjistrin noterial, administruar nga Ministria e Drejtësisë, mbetet për t'u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit.

12. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që, brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, për hetimin e këtyre dy çështjeve të reja dhe të pahetuara. Komisioneri Publik konstaton se konkluzionet e tjera, të arsyetuara në vendimin përkatës të Komisionit, janë të tilla, që nuk e bëjnë të cenueshëm atë.

13. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit, ushtrohet për nevoja të hetimit të këtyre dy çështjeve të lartpërmendura.

III.A. Shkaqe të ankimit për hetim të mëtejshëm

14. Referuar edhe përmbajtjes së Rekomandimit të një Komisioni prej 3 Vëzhguesish Ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se nga Regjistri Elektronik i Noterëve, i cili përmban mes të tjerash edhe të dhënat e akteve dhe veprimeve noteriale, në emër të subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2019, rezulton një akt noterial me nr. ***, datë ***.8.2015, për shërbimin “kontratë huaje”, për të cilin rezulton se nuk është hetuar nga Komisioni. Rezultatet e hetimit në lidhje me përmbajtjen e kësaj kontrate huaje mund të ndikojnë në aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, në funksion të natyrës së marrëdhënies së huas, për vitin përkatës të lidhjes së kësaj kontrate.

15. Referuar përmbajtjes së Rekomandimit të një Komisioni prej 3 Vëzhguesish Ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në datën 10.11.2020, në adresë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është dërguar një denoncim, ku pretendohet se subjekti i rivlerësimit disponon 15% aksione te firma “****.***.***” sh.p.k., me administrator z. ***.***.

15.1 Komisioneri Publik vlerëson se ky denoncim duhet shqyrtuar gjatë procedurës gjyqësore në Kolegj, pasi pretendohet për pasuri të padeklaruar, të fshehur, të subjektit të rivlerësimit, që për shkak të momentit të paraqitjes së denoncimit, nuk ka qenë i mundur të hetohet.

IV. Kërkimi i ankimit

16. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj

vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

17. Duke nënvizuar se Komisioneri Publik, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c”, të aneksit të Kushtetutës është institucioni i rivlerësimit, të cilit Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i drejton rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit;

18. Duke ndarë mendim të ndryshëm me Komisionerin Publik z. Darjel Sina, i cili, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja ”c”, ka paraqitur një raport me shkrim, ku argumenton se Rekomandimi i Komisionit prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtarë, datë 11.11.2020, paraqitur Komisionerëve Publikë për të paraqitur ankim, nuk i ndryshon bindjen e brendshme dhe provat e analizuarat prej tij, gjatë hetimit të vendimit të Komisionit, duke mos ushtruar ai ankim;

19. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit B/3, pika “c”, C/2, Ç dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se në rastin konkret, zbatimi i nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 mund të rezultojë vetëm pas hetimit të mëtejshëm të këtyre çështjeve;

20. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Ndryshimin e këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhen këtij ankimi:

- Rekomandimi nr. 865/1 prot., datë 11.11.2020, i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe aneksi i tij.
- Raporti i Komisionerit Publik z. Darjel Sina, datë 12.11.2020.